

Procesverbal

Nga mbledhja I (e parë) e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:31.10.2023

Rend Dite

- 1) Propozim Vendim për anulimin e vendimeve 01 Nr.941/01-24752-6/23 të datës 15.09.2023, për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) për Komunën e Dragashit dhe Vendimit 01 Nr.941/01-24752-5/23 i datës 15.09.2023, për iniciimin e procedurës për hartimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK-së),
- 2) Vendim për caktimin e Normave Tatimore për Tatimin në Pronën Pronën e Paluajtshme për vitin 2024,
- 3) Miratimi i Statutit të Muzeut të Komunës së Dragashit.

Uran Halimi: Po fillojmë me seancën e parë të jashtëzakonshme për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës. Faleminderit për pjesëmarrjen edhe prezencën e juaj! Ju e dini që si rend dite kanë qenë tri pika të cila jua kemi servue edhe në material. Në pikë të parë është Propozim Vendim për anulimin e vendimeve 01 Nr.941/01-24752/23 të datës 15.09.2023, për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) për Komunën e Dragashit dhe Vendimit 01 Nr.941/01-24752-5/23 i datës 15.09.2023, për iniciimin e procedurës për hartimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK-së); pika e dytë është Vendim për caktimin e Normave Tatimore për Tatimin në Pronën Pronën e Paluajtshme për vitin 2024; pika e tretë edhe e fundit është Miratimi i Statutit të Muzeut të Komunës së Dragashit. Nëse do me e marrë fjalën dikush në lidhje me këto pika të rendit të ditës? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë konstatoj që me 23 vota pro, me zero kundër edhe zero abstenim, kalon rendit i ditës. Vazhdojmë me pikën e parë. E kemi Propozim Vendimin për anulimin e këtyre dy vendimeve të cilat i kemi marrë më herët. Kush do me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Arsyeja pse na është kërkue anulimi i këtyre dy vendimeve është që që të dyjat këna me u bë me një dokument të përbashkët, jo veç e veç, qysh janë bë ma herët. E qesim në votim edhe pikën e parë. Kush është pro, për anulimin e këtyre dy vendimeve? Kush është kundër? Abstenim? Me 16 vota pro, me zero kundër edhe 9 abstenime, kalon pika e parë e rendit të ditës. Te pika e dytë e kemi Vendimin për caktimin e Normave Tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024. Nëse do dikush me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? E ka kërkue fjalën z.Driton Ademi. Është mirë me e dhënë një sqarim, dejtör.

Qamil Kolloni: Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesues, zv/kryesues, delegatë dhe ju të gjithë të pranishëm! Propozim Vendimi për caktimin e Normave Tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024, ju e dini se këto norma tatimore ka të drejtë Kuvendi Komunal që t'i miratojë, kurse vlerësimin edhe shkallën e normave e bën zyra përkatëse e vlerësimit që është në kuadër të Departamentit të Tatimit në Pronë, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Pse kemi ardhë deri te këto norma tatimore? Duhet të jeni të informuar që pritet se vitin e ardhshëm të tatimohen edhe pronat bujqësore. Na kemi shkue në normën minimale të tatimit në prinë, në shkallën 0.10%. Kemi bërë ndryshimin për njësitë komerciale të objekteve e cila ka qenë vitin e kaluar 0.18%, e kemi ulë në 0.16%. Normat tjera tatimore janë tërësisht qysh kanë qenë vitin e kaluar. Sa i përket njësite industriale të objekteve, 0.18% është edhe këtë vit, për arsye se nuk kemi shumë objekte industriale. Ju e dini që edhe vitin e kaluar është bërë një bisedë e madhe sa i përket tatimin në pronë. Komuna jonë kemi kalue, për fat të mirë, me Vendim të këtij Kuvendi kur e kemi ulë nga 0.18% në 0.15%, kemi kalue shumë mirë. Pikërisht si ulje e normave tatimore kemi pas rezultate pozitive në inkasimin e tatimit në pronë. Prandaj unë ju propozoj – se kemi shkue me të njëjtën filozofi, me norma sa më të ulëta dhe me çmime më të vogla, që të arrijmë të kemi rezultate, për arsye se numri i klientëve po paguajnë më shumë kur po kanë më pak obligime, sesa kur po na rritet edhe po akumulohet borxhi i përgjithshëm. Prandaj, ju kisha lut si delegatë që ta miratoni këtë propozim-vendim!

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Fjalën ia kalojmë z.Driton Ademi.

Driton Ademi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Unë e dëgjova drejtorin me vëmendje, që tha i kemi ulë disa norma të njësite bujqësore edhe disa të tjera. Unë po e shoh të arsyeshme – nëse ti po mendojsh që kemi mbledhë shumë të hyra – po propozoj që për njësi rezidenciale të objekteve nuk e keni ulë qet shumë, që është shumë më urgjente për qytetarët. Unë po propozoj që për njësitë rezidenciale të objekteve nga 0.15% që është, me e ulë në 0.10% edhe këtë. Domethënë, i kam tri propozime prej kësaj: për njësitë komerciale të objekteve nga 0.16% në 0.13%, dhe për njësitë industriale të objekteve nga 0.18% në 0.15%. Domethënë, më e rëndësishmja është për njësitë rezidenciale të objekteve, janë objekte banimi. Për shpiat nuk e keni ulë asnjë normë. Tash po ia ulish bujqësisë, mos me ia ulë shpiave, e po presish me mbledhë tatim, unë këtë nuk po e shoh shumë të arsyeshme. Unë propozoj që këto triat me dalë me këto norma. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, Driton! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Sa i përket normave të tatimit, unë e di që ekziston një lidh ku bazohen këto. Domethënë, janë normat prej ku është minimumi edhe deri ku është maksimumi. A do me e marrë fjalën dikush tjetër, përveç drejtorit? Nëse s'ka diçka tjetër me pyet, atëherë e përmbyllim me drejtorin.

Qamil Kolloni: Driton, mirë kishte qenë të propozosh. Përpos normës tatimore, kemi edhe vlerë.

Vlerën të cilën e bëjmë në bazë të komisionit të vlerësimit, ku i kemi shfrytëzuar të gjithë inputet tona, të cilat i kemi dhënë dhe kanë ndikuar në uljen e çmimeve. Nëse duesh, po ta shpjegoj edhe me formulë. Ne kemi pesë zona dhe tri zona janë që kanë vlerë monetare. Nën tri zona janë pa vlerë monetare, për arsye se kemi pas 250 euro metrë katror në kohën e PDK-së, të qeverisjes suaj, dhe e kemi ulë në 240 metrë katror vlerë. $240 \times 100 = 24$ mijë euro. 15 mijë euro i fal Qeveria, i minusojsh, mbetin 9 mijë euro. 9000×0.15 bëjnë 13.50 euro. Kurse ju e keni pas vlerën e tatimit në pronë 250 euro që herë 100 bëjnë 25 mijë euro. 25 mijë euro minus 15 mijë që i fal Qeveria, mbetin 10 mijë euro. 0.17 e ke pas normën tatimore, 17 euro. Dhe tash për 100 metra katrorë paguan 13.50 euro për një objekt. Kurse ti e ke pas 17 euro. 0.15%-shi është limiti ligjor i uljes së normës tatimore, që nën këtë për këto objekte nuk mundim me shkue më poshtë. Për këtë arsye, unë thashë se të gjitha mundësitë i kemi shfrytëzuar që të krijojmë një bazë të mirëfilltë tatimore, që të kemi suksese dhe rezultate. Asnjë tatimpagues nuk është i atakuar vitin e kaluar edhe këtë vit, sa i përket tatimit në pronë. Të jesh mëse i bindur! Për të gjitha kategoritë, kryetar, vlen e njëjta filozofi, në qoftë se është në gjendje me e kuptue. Të gjitha janë shfrytëzuar në shkallën minimale të normës.

Uran Halimi: Falemnderit, drejtor! Atëherë e hedhim në votim pikën e dytë të rendit të ditës. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? S'mundim na me e bo një propozim që s'na lejon ligji. Po s'kemi hapësirë, o Driton, me e realizue propozimin tënd edhe është absurde me e qit në votim. Hajde po e qesim në votim propozimin e z.Driton Ademi.

Qamil Kolloni: E keni preambulën ku është i bazuar. Ligji Nr.08/L224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 06/L055 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Kuvendi i Komunës së Dragashit cakton normat tatimore për vitin 2024. Konform këtij Ligji, i kemi marrë normat minimale. Po na po i propozojmë, po konform Ligjit. Me propozue ke të drejtë, por në limite të ligjit, mbi nuk mundesh dhe nën nuk mundesh. Mundesh me i rrit sa të duash ti, por nën këtë limit s'mund të biesh. Për këtë arsye po të them se janë marrë normat minimale, përpos për njësitë industriale të objekteve që është 0.18%, thashë nuk kemi objekte industriale. Nuk keni çka me hezitue me votue kundër ose pro, është propozim-vendim më i mirë i mundshëm.

Uran Halimi: Të nderum delegatë, te Ligji 08/224 e kemi ku është shkalla tatimore progresive, domethënë janë të cekura shumë qartë cilat janë variablat që mundim me i ndryshue.

Qamil Kolloni: Për vlerën e pronave deri në 100 mijë euro është 0.10%; për vlerën e pronave mbi 100 mijë euro është 0.20%; për vlerën e pronave mbi 500 mijë euro është 0.30%; për vlerën mbi 1 milion është 0.40%; për vlerën mbi 5 milion është 0.50%.

Uran Halimi: Falemnderit, drejtor! Nedžmidin Sejdirar e kërkoi fjalën.

Nedžmidin Sejdirar: Përshëndetje të gjithëve, nuk shoh asnjë pengesë që ne këtu në kuvend të votojmë

propozimin e kolegut tim. Mund të jetë e paligjshme, por demokracia parlamentare vendos vullnetin e qytetarëve. Ne kemi pasur shembuj në këtë kuvend ku vetë qeveria ka sjellë në votim vendime që kanë qenë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin, ato vendime kanë kaluar, janë kthyer nga ministria për rishqyrtim, janë kthyer sërish. Nëse do të kishit pak durim dhe do të më dëgjoni deri në fund, do të vijja deri te pika e dytë. Çdo delegat ka të drejtë të propozojë çdo gjë për votim. Nëse propozimi i tij ka vota të mjaftueshme, propozimi i tij do të kalojë. Kolegu Driton ka të drejtë të propozojë 0.00 1%, që është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin, nëse i ka votat, propozimi i tij kalon në kuvend, ministria ia kthen dhe kaq.

Uran Halimi: Nedžmidini, fol për tatimin në pronë, jo a ka të drejtë a s'ka të drejtë, se unë e di a keni të drejtë a s'keni të drejtë. Mu po më vjen shumë keq me ardhë deri te qekjo pikë e diskutimit edhe me folë për çështje që sinqerisht nuk më takojnë. Është e turpshme një delegat i Kuvendit Komunal me bo propozime të jashtëligjshme. I bjer se ju s'e keni lexue as materialin, edhe unë kam të drejtë me propozue, pse jam delegat edhe mo munda me i pas do vota, kjo është e turpshme. Më së pari duhet me e lexue atë pikë të rendit të ditës, ligjin ku është bazue kjo pikë e rendit të ditës edhe me kqyr ti çka kие të drejtë me propozue. E jo pse ti, kam të drejtë unë, hajde po propozoj diçka që s'ban me e qit në propozim. Kie material, e kie ligjin, në internet kie material sa të duesh. Qe unë ku e gjeta ligjin. E kie ti ligjin ku po bazohet kjo pikë e rendit të ditës, ku po bazohen këto norma tatimore. Po vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, pa propozim të z.Driton Ademi. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? Okej, ankohuni! Kush është kundër? Abstenim? I kemi 14 vota pro, 1 kundër edhe 4 abstenime, të tjerët janë të padeklaruar, kalon edhe pika e dytë e rendit të ditës. E kemi pikën e tretë me radhë, është miratimi i Statutit të Muzeut të Komunës së Dragashit. Nëse ka pyetje dikush? E ftojme drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sport që ta prezantojë këtë statut.

Liridona Misinaj: I nderuar kryetar, i nderuar kryesues, të nderuar delegatë, fillimisht më lejoni të ju përshëndes dhe në pika të shkurta ta prezantoj Draft Statutin e Muzeut të Etnologjik që mundëson themelimin e Muzeut në Komunën tonë. Muzeu i Dragashit është formuar në vitin 2014 me mbështetje të organizatës suedeze CĒB, mirëpo për ta funksionalizuar kërkohet miratimi i Statutit nga Kuvendi i Komunës, i cili e mundëson themelimin dhe funksionalitetin e tij. Mbi këtë bazë, ne kemi sjellë para juve Draft Statutin, i cili ka kaluar nëpër të gjitha procedurat, duke përfshirë edhe diskutimin publik në afat prej një muaji, ku qytetarët kanë pasur mundësinë të paraqesin vërejtjet, sugjerimet dhe komentet e tyre. Pas konsultimit publik dhe në konsultim me stafin e Burimeve Njerëzore dhe Ligjin për Shërbyes Civilë, kërkojmë që të ndryshohet Neni 13, pika I, domethënë që "menaxher i Muzeut të zgjidhet personi i cili përveçkushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet të ketë edhe përgatitje superiore." Të nderuar delegatë, themelimi i Muzeut ka rëndësi të madhe, ngase është institucion i cili

ruan, promovon dhe prezanton trashëgiminë kulturore të Komunës sonë, e cila është ndër më të pasurat në Kosovë. Aktualisht, në Muze gjenden të ekspozuara sende me vlerë etnografike që kërkojnë përkujdesje, ngase ato janë element i rëndësishëm i peizazhit tonë kulturor. Ato dokumentojnë se kush kemi qenë, kush jemi dhe tregojnë se kush do të bëhemi në të ardhmen. Rëndësia e themelimit të Muzeut është e shumëfishtë. Ai shërben si qendër kulturore dhe historike në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë tonë kulturore e historike, ku mund të ekspozohen e studiohen artefakte historike, përfshirë karakterin edukativ, ku përmes organizimit të ekspozitave dhe aktiviteteve të ndryshme edukative, mund të promovohet njohja mbi historinë, kulturën dhe trashëgiminë e Komunës sonë. Gjithashtu, Muzeu mund të ndihmojë në zhvillimin e turizmit lokal, duke tërhequr turistët dhe të kontribuojë në rritjen ekonomike lokale. Muzeu dhe turizmi kanë një lidhje të ngushtë, ngase e ndikojnë njëri-tjetër dhe paraqesin atraksione për vizitorët. Përgjithësisht, themelimi i Muzeut në Komunën tonë është një hap i rëndësishëm për ruajtjen e kujtesës së vendit dhe promovimin e trashëgimisë kulturore-historike. Të nderuar delegatë, duke qenë se Muzeu qëllim kryesor ka të ruajë dhe promovojë vlerat kulturore-historike të Komunës sonë, ne besojmë se Draft Statuti që kemi para vetes do të miratohet nga ana juaj, do të mundësohet themelimi dhe rregullohet statusi juridik i Muzeut të Komunës së Dragashit, duke përfshirë edhe veprimtarinë e Muzeut, organizimin, përfaqësimin, planifikimin dhe buxhetin për funksionalitetin e tij. Pas përfundimit të këtyre procedurave, Muzeu do të jetë i hapur për publikun dhe do të ofrojë shërbime muzeale. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, drejtoreshë! Nëse do dikush me e marrë fjalën? Po e marr unë fjalën, kam disa pyetje për drejtoreshën.

Të nderum kolegë delegatë, ju përshëndes! Sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, e dëgjova drejtoreshën me kujdes. Kisha pas dëshirë me na informue cila do të jetë përbërja e stafit të këtij Muzeu. Pyetja tjetër, cilat janë organet e Muzeut. Edhe sa i përket financave, nga ku keni me i marrë financat, kur në planifikim buxhetor nuk ka pas ndarje buxhetore në lidhje me Muzeun, domethënë nuk ke pas mjete të parapara në lidhje me këtë Muze. Edhe te ju që e cituat aty, Nenin 13 te pika 1, te Ligji për Shërbyes Civilë, thotë që kryetari e emëron drejtorin me mandat katërvjeçar, me kontratë katërvjeçare. Nëse ia bën kontratën katërvjeçare, e ka problem me e shkarkue mandej. Te Neni 13, pika e parë, aty, po thaje diku ma poshtë shkruan që kryetari e emëron me mandat katërvjeçar, me kontratë katërvjeçare. Me kontratë katërvjeçare nëse e emërosh, është problem me e shkarkue, jo me kontratë, s'e di a munden me e emëru drejtorin. Falemnderit, në qeto pyetje nëse mundesh me m'u përgjigj!

Qamil Kolloni: Muzeu Etnografik është krijue shumë ma herët, mirëpo për t'u regjistruar dhe për t'u evidentue u dashtë që të krijohet Statuti. Vitin tjetër parashihet në KAB, ku i paralajmërohet Qeverisë edhe për Nenin 13 të cilin e kie në këtë Statut, për menaxherin e Muzeut, drejtorin dhe organet. Pasi që

të paralajmërohet Qeveria për këto organet, fillon konstituimi i këtyre organeve dhe zgjedhja e këtij personeli, si dhe parashihet linjat buxhetore për t'u implementuar ky Statut. Pra, kjo na merr kohë përafërsisht një vit, për me e sjellë edhe me e rregullue krejt këtë çështje të Muzeut Etnografik.

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Te Neni 28, në fund të Statutit, po thotë që ky Statut hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë. Domethënë, nuk hyn në implementim në mot, qysh po thuesh ti, po mas 15 ditëve bëhet publik dhe hyn në fuqi. I patëm edhe dy pyetje tjera për drejtoreshën: përbërjen e stafit, organet e Muzeut, për paret po thotë në mot jau japim, sivjet s'keni pare. A do me u përgjigj drejtoresha, apo jo? Okej, dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Nexhat Selaj e ka kërkuë fjalën.

Nexhat Selaj: Përsëndetje kryetar, përsëndetje kolegë! Më lejoni një herë që fillimisht ta përgëzoj drejtoreshën për një hap të tillë, se besoj se ka pas nevojë që të është një ekspert i një fushës, siç është një historian me një përvojë trivjeçare apo katër, pavarësisht. Por një replikë pak të vogël z.Qamilit. Kur din me thënë se në kohën e PDK-së kanë qenë kaq tatimet dhe ne i kemi zvogëluë, i kemi qit në kaq, pse s'e marrësh guximin të thuash që falë PDK-së dhe shoqatave suedeze është, është themelue nga Partia Demokratike, por vetëm japish ato anët pozitive të cilat i krijoni gjatë partisë juaj. Pavarësisht asaj, unë do ta mbështes drejtoreshën që ka marrë një hap të tillë dhe, për mendimin tim, është më se e qëlluar. Falemnderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Selaj! Ta kqyrim mos kemi edhe pyetje tjera edhe mandej po ta jap fjalën, drejtor. Dikush tjetër a do me pyet diçka? z.Munir Jonuzi e ka kërkuë fjalën.

Munir Jonuzi: Të nderuar të pranishem, me sa kuptova drejtoresha kerkoi ndryshim në nenin 13 për përzgjedhjen e menaxherit që përvec kushteve të pergjithshme të parashikuara në ligj duhet të plotesoje edhe kushtin e arsimit të larte në fushen e historise. si menaxher i muzeut, kështu është te ne, ju tani doni të ndryshoni vetëm me arsim universitar dhe jo direkt nga fushën e historiasë. Unë kam një ndryshim në nenin 15, kolegjiimi i ekspertëve përbëhet nga pesë anëtarë të cilët emërohen në konsultim me sektorin e kulturës dhe nga drejtorja e kulturës, rinisë dhe sportit, për një periudhë tre vjeçare, dhe do të shtoja këtu, duke respektuar diversiteti në strukturën e popullsisë. Prandaj, duhet të përfshihen edhe anëtarët nga komuniteti joshumicë.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Jonuzi! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Dona, veç një pyetje e kemi të paqartë. Ti propozove njëfarë ndryshimi me e bo. A mundish me në thënë se, më fal, s'un munda me e kap këtë pjesën, cili është propozimi për ndryshim?

Liridona Misinaj: Ne kërkojmë që menaxheri i Muzeut të zgjidhet personi i cili, përveç kushteve të pergjithshme të parapara me ligj, duhet të ketë përgatitje superiore. Në vazhdim është aty në fushat e shkencave dhe historisë, dhe së paku të ketë 3 vite përvojë pune në lëminë e trashëgimisë kulturore.

Mos po bjer ndesh me nenin i cili nuk e respekton parimin e barazisë në konkurs. Për atë arsye.

Uran Halimi: Edhe te kjo pjesa ‘konkursit publik të shërbimit civil’, Ligji për Shërbyes Civilë nuk është aktiv mo, drejtoreshë. S’mundim me u bazue te Ligji për Shërbyes Civilë, se nuk është në fuqi. Edhe këtë pjesën duhet me e hek te Statuti i Muzeut. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? z.Kolloni e ka kërkue fjalën.

Qamil Kolloni: Nexho, realisht unë jam duke u mundue me u marrë me punë profesionale edhe nuk e thashë në kontekstin negativ. Ka qenë norma 0.17, 0.15, me qeta delegatë edhe me ju e kemi pru qat normë vitin e kaluar. Se ka qenë PDK-ja në udhëheqje ka qenë në realitet. Sa i përket këtij Muzeut, prapë nuk e thashë në kontekstin negativ. Unë e di shumë mirë se ai që në vitin 2014 dhe në 2016 kur ka përfundue ky projekt, ka qenë dashtë të bëhet regjistrimi dhe evidentimi. Unë e kam pas prej Auditorit si të gjetur mosregjistrimin e Muzeut Etnografik. Dhe në mënyrën më të mirë të mundshme, jam konsultue me zyrtarët që prapë janë të PDK-së, dhe e kemi gjet formën më të mirë ligjore për me i mbulue të gjitha vakumet nga 2016 deri në 2023 që nuk janë bërë në atë Muze. E kemi gjet mënyrën ma të mirë të mundshme për me e mbulue atë vakuum. Këtu nuk ka kurgjo të keqe, s’di sa po më kuptosh, po unë nuk kam dashtë të lëshohem në aspektin politik se pse ka ndodhë, qysh ka ndodhë edhe pse s’është realizue. Por, thashë metodën se si kemi me e përfundue këtë cikël, që nga 2016-ta nuk e ka marrë formën e duhur. Nuk po due me hi pak ma shumë me elaborue, se dalin edhe gjëra që nuk due me i thënë edhe s’jam i prirë me i thënë. Për këtë arsye, unë isha shumë korrekt, që është bërë një punë, po e vazhdojë edhe me një punë më të mirë edhe po e përfundojmë, kurgjo të keqe s’ka.

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Shpetim Hajredini e ka kërkue fjalën?

Shpetim Hajredini: Faleminderit, i nderuar kryesues! Përshëndetje i nderuar kryetar, të nderuar drejtorë, kolegë asambleistë dhe ju qytetarë të cilët po na ndiqni direkt! Ju përshëndes të gjithëve! Realisht, unë desha ta marr fjalën qysh në fillim dhe të jap mbështetjen time për këtë Statut, për Statutin e Muzeut të Komunës së Dragashit. Pastaj dolëm pak në politikë dhe, i nderuar drejtor, nuk po ta marr për të madhe se nuk po e potenconi që në vitin 2014 ka qenë PDK-ja në atë kohë në ekzekutiv, në qeverisje. Por, po ta marr pak për të madhe që dole dhe bëre replikë me profin Nexhat, se edhe ky e tha atë realitetin. S’ke çka mujsh me e kundërshtue në këtë drejtim. Tjetra, Nenin 13 ne e lexuam dhe drejtoresha e potencoi dy herë që po bëhet një ndryshim, dhe logjikisht mu nuk po ma rrok. Pse të bëhet ndryshimi, kur është, po mendoj se është shumë në rregull ashtu si është potencu dhe është specifiku këtu. Menaxheri i Muzeut zgjidhet personi i cili, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet të ketë edhe përgatitje superiore nga fusha e shkencave të historisë dhe së paku 3 vite përvojë pune në lëminë e trashëgimisë kulturore. Shumë adekuate është, unë nuk e di ku do të ndeshet ky Nen

dhe me çfarë ligji do të ndeshet. Është shumë adekuat dhe unë personalisht prapë do ta mbështes, por nuk kisha thënë se duhet të ndryshohet ky Nen, pasi që është në bazë të aftësive dhe është shumë në rregull. Por, ju prapë vendosni dhe duhet ta specifikosh, i nderuar kryesues, që kur të votojmë, të votojmë me ndryshimet që na i propozoi drejtoresha, apo nuk do të shkojmë më ndryshime dhe do të votojmë kështu si na ka ardhë materiali, që ta dimë na pastaj se çka po votojmë dhe ku jemi. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, i nderum koleg! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Deshta me u ndërlidhë edhe me diçka, përveç këtyre përgjigjeve që s'i mora prej drejtoreshës (cila është përbërja e stafit të Muzeut). Unë të pyeta cila ka me qenë përbërja e stafit të Muzeut, cilat kanë me qenë organet e Muzeut. Veç një sekond! Po s'un e marish fjalën pa ta dhënë unë! Mundish me e marrë fjalën masi ta kryej unë. Ju lutem, shkoni në vend, mandej e marrish fjalën! Përveç këtyre përgjigjeve që s'i mora, te Ligji i Zyrtarëve Publikë, mundish me ra ndesh, atë propozimin që e bëre, që me e hek këtë pjesën që të ketë përgatitje superiore nga fusha e shkencave të historisë. Nëse e hekim na këtë kriter, atëherë bina ndesh me ligjin, znj.drejtoreshë. Pa të keq, se po të kallxoj qysh është puna e ligjit. Nëse e hekim na kërkesën që ky drejtori ose menaxheri me qenë nga fusha e historisë, bina ndesh me Ligjin për Zyrtarë Publikë, i cili i cakton kriteret se qysh është paraparë në pikën e parë të Nenit 13. Domethënë, është i njëjti kriter qysh e kie te Neni 13, pika e parë, kriteret janë të njëjta. Na nëse i ndryshojmë kriteret, na nuk kemi të drejtë me i ndryshue kriteret, se këtë e cakton Ligji për Zyrtarë Publikë, e nderume drejtoreshë. Nëse na e propozojmë këtë ndryshim në Statut, neve na kthehet prapë edhe bëjmë shkelje ligjore. Na nuk kemi të drejtë me i caktue kriteret, se nëse e hekim na historianin në Muze, ia centirativim aty me pru ekonomist, ose jurist, ose çkadoqoftë tjetër. Në Muze, znj.drejtoreshë, duhet m'u konë historian, se këtë ligji ta cakton. Është mirë me e tërheq këtë propozim edhe po vazhdojmë. Mos e merr personale, mos u acar, fjalën ta jap sa herë, mundesh me e marrë fjalën qetash. Okej, faleminderit! Fjalën e ka kërkuë znj.Arijeta Skeraj.

Arijeta Qaflehi Skeraj: Përsëndetjë kryetar, përsëndetjë kryesues, përsëndetjë për të gjithë të pranishmit! Me vëmendje e dëgjova drejtoreshën e Kulturës, edhe mu më ka ardhë shumë mirë që e ka marrë këtë iniciativë dhe gjatë gjithë foljes së saj më pëlqeu. E para duhet thënë që kush e ka nis atë Muze e ka nis, nuk duhet të merret me politikë këtu. Neve politika na ka pru këtu, po nuk duhet kush e ka bo. Nisma ka qenë e mirë, drejtoresha ka fillue edhe më mirë. Unë deshta kryesuesit t'i them që statutet e Komunës gjithmonë Kuvendi i ka hek pikat, i ka vu pikat, qysh e ka pa të arsyeshme. Besoj që nuk është aq keq që na me ndërrue atë pikën, se çdo herë Kuvendi e ka marrë që statutet munden të ndërrohen brenda Kuvendit, normal që me miratimin e shumicës. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, snj.Skeraj! Ne e patëm diskutimin edhe të Driton Ademit që e bëri

propozimin. Ne diskutuam edhe për rastin e Dritonit njëjtë, na s'mundin me marrë vendime që janë të jashtëligjshme, që bien ndesh me ligjin, se edhe statuti bazohet në ligj. Nëse e cekim që po bazohet në ligj, e thotë Ligji për Zyrtarë Publikë. S'munden Kuvendi me marrë vendime të jashtëligjshme, znj.Skeraj. Na si Kuvend duhet me ndjek ligjin, bile na duhet me qenë njerëz të ligjit, e jo me bo propozime të jashtëligjshme edhe me marrë vendime të jashtëligjshme. Është e ulët. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e kërkoi z.Gashi, pas tij fjalën e ka z.Munir Jonuzi.

Agron Gashi: Atëherë, ju përshëndes të pranishëm! Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesues dhe ju të gjithë të tjerët! Në këtë pikë diskutimi për Muzeun deshta të lidhem, se është për t'u përshëndetur dhe një sukses i arritur në këtë drejtim. Meqenëse vij nga fusha arsimore, plani dhe programi zhvillimor që nga klasët e hershme, II, III, IV dhe V, fillojnë të mësojnë nxënësit lidhur me muzeun. Meqenëse Komuna jonë nuk ka pasur mjaftueshëm organizime të tilla, unë konsideroj dhe drejtoreshën e Kulturës e uroj që në të ardhmen të keni mjete dhe të siguroni edhe për nxënësit transportin dhe t'i sjellim për të parë direkt se ç'është muzeu. Të shohim historikun që nga kohërat e lashta, deri në mesjetë e ditëve të sotit. Është për t'u përshëndetur, thashë, se luan një rol shumë të rëndësishëm, ku fëmijës i jepet mundësia të shohë në mënyrë direkte. Meqenëse edhe shpeshherë i kemi drejtuar në drejtim të Prizrenit, në Muzeun e Prizrenit dhe kanë parë atje, unë i kam pasur, çdo gjeneratë e kam drejtuar deri atje. Atëherë, do të na jepet mundësia që ma konkretisht të mësojmë edhe mbi vlerat e Komunës sonë. Aty thotë se duhet të kemi edhe një xhirollogari të posaçme, në ndarjen e mjeteve që Komuna do të ndajë për çdo vit, por gjithashtu edhe ato mjete që do të furnizohet Muzeu, disa prej tyre mund edhe të blihen. Do të thotë se është përgjegjësi komunale edhe të sigurojë mjete për blerjen e disa vlerave apo mjeteve, por njëkohësisht edhe ka njerëz të tillë të cilët ato do t'i dhurojnë nga dëshira e tyre. Kjo iniciativë e marrë është një hap më tej, tek fëmijët tanë, që do të luajë një rol shumë të rëndësishëm për të kaluarën e popullit tonë. Faleminderit shumë!

Uran Halimi: Faleminderit! Fjalën e ka Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Lexova Statutin e Muzeut Kombëtar, ata ne piken 12 te tyre thone qe drejtori duhet te kete nje diplome universitare ne nje dege si historia, muzeologjia, antropologjia, trashegimia kulturore dhe arti apo disa shkenca te tjera shoqerore, ndaj jam i mendimi se po të heqim këto "shkenca historike" nuk do të biem në kundërshtim me ligjin, sepse Statuti i Muzeut Kombëtar e ka përcaktuar kështu. Nëse tani përcaktojmë diçka të ngjashme me sa më sipër, nuk do të biem në kundërshtim me ligjin. Nuk shoh asnjë pengesë ligjore për heqjen e shkencave historike, sepse mund të përfshijmë edhe shkenca të tjera shoqërore. Keni parasysh ndryshimin tim që bëra kur e vendosni në votim Statutin e Muzeut.

Xhylferie Bahtijari: Përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje kryetar! Arsyeja pse unë dola sot në foltore, temën që jemi duke e diskutuar nuk kam fjalë, nuk kam përgjigje, vetëm dua t'i drejtohem

kryesuesit me mënyrën se si sillet me një femër. Domethënë, unë kam dalë në foltore, jo nga aspekti politik ose diçka tjetër, nuk kam të bëj me personin në fjalë që nuk po ia përmendi emrin, vetëm po i qasem problemit nga këndvështrimi femëror. Përderisa, kryesues, ke pas disa raste të shumta, mos të them me numër, kur nga ana e kandidatëve ose nga ana e drejtorëve mashkuj kanë ardhë dhe, në njëfarë mënyre, ta kanë marrë fjalën me zor, dhe i ke tolerue vetëm nga frika që është mashkull, dhe e kthen një drejtoreshë që është femër dhe deshi të përgjigjet në pyetjen tënde. Nëse ti ke pas pyetje të tjera, ke mund t'i drejtohesh në momentin që ajo i përgjigjet pyetjes së mëparshme dhe përderisa ajo është në foltore. Ose, mundësia tjetër, t'i përgjigjet pyetjes që e bëre më herët, dhe drejtoresha nëse ka dëshirë t'i përgjigjet pyetjeve tjera tuat. Jam në mbështetje femra-femrës. Nuk po kërkoj përparësi, kryesues, por po kërkoj barazi gjinore. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, znj.Bahtijari! Temat po kalojnë prej njëres në tjetrën, sidoqoftë, unë jam jo për barazi gjinore, por jam për përparësi në aspektin e gjinisë së kundërt. Je shumë gabim. Nëse na kemi pas raste ku është marrë fjala pa iu dhënë, edhe ju doket diçka e hijshme edhe në rregull, që doni e vazhdojmë na qashtu. Dilni e merrne fjalën ju qysh të doni, ju kur doni, pa jau dhënë kërkush. Po, lë që kemi me i çue në vend, po edhe përjashta kemi me i qit, këtë jau garantoj. Edhe përjashta kemi me i qit, këtë sot e tutje jau garantoj. Po në rregull, duhet me pas rend, me krejt unë e bëj, jo veç me atë. Sidoqoftë, nëse jeni me punue jashtë rregullave, atëherë bile të dalim pa e marrë fjalën kërkush. Jo, rregullat gjithmonë kemi me i mbaj, ama s'mundi unë me dalë me u ballafaque fizikisht me ta. E çka me bo, kënd e kam tolerue, a mundesh me m'i përmend me emra? Kanë qenë njerëz, drejtorë, qysh thaje, delegatë të partisë së juaj sidomos. S'kam tolerue të VV-së, të PDK-së edhe ma hiç, Veç ekzekutivi edhe partia juaj i ka bo qeto. Nga kush? Sjellja ime erdh si pasojë e një sjellje tjetër jo të mirë, paraprake. Po më vjen shumë keq! Fjalën e kërkoi z.Nexhat Selaj.

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe një herë! Po ndalem te Neni 13, që e propozoi drejtoresha. Edhe pak më parë, drejtoreshë, t'u drejtova se do ta mbështesë plotësisht. Por, nuk po muj të shoh arsyen pse me e nderyshue, përderisa po sqarohet mirë: Përgatitje superiore nga fusha e shkencave të historisë. Këtu bën pjesë, në kuadër të fushave të historisë, edhe etnografia, bën edhe etnograf. Nuk po shoh të arsyeshme çka me ndryshue. Pavarësisht, me ndryshim nuk mund ta mbështes, por kështu si është si e tillë, e shoh të arsyeshme. Nuk po due të hyj tash në polemikë. Kryesues, duhesh ta dish vendin ku e ke. Po më vjen keq, ajo ke urdhër (shko në vend!), që mua si delegat nuk më ka pëlqyer. Mendimi im është t'i kërkosh falje drejtoreshës, e jotja është të vendosësh. Mua nuk më pëlqeu, si e hijshme nuk m'u dok. Nuk ishte për duartrokitje, unë e fola atë çfarë e ndjeva vetë. Si femër, u desht të ketë pak përparësi. E dyta, nuk bëri asgjë që ta urdhërosh, t'i thuash shko në vend. Mua nuk m'u duk, si profesor, nuk m'u duk e hijeshme, edhe nëse ka gabue diçka. E hijeshme nuk m'u duk. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Selaj! Unë ty të kam pas profesor, të kam ngue vazhdimisht. Jam tolerant, po të kërkoj falje drejtoreshë, nëse jam sjellë në qat mënyrën që ti po mendojsh. Është mirë me kërkue falje edhe ti, nëse të paktën e ndijsh veten fajtoreshë. Është mirë, edhe po ju premtoj, që sot e tutje fjalën pa jau dhënë s'un keni me e marrë. Kushdoqoftë, s'ka dallime këtu. Kush? Ju lutem, drejtor, sot e tutje më mos e bëni, se ju çoj në vend edhe ju them shkoni në vend. Këtë kam me jau thënë, në vend kanë me shkue. Ata që dalin pa pyet, në vend kanë me shkue, ose kanë me dalë jashtë. Këtë e keni të garantuar. Nëse delni, ju lutem, sot e tutje, nëse dikush del me e marrë fjalën pa ia dhënë fjalën unë, ka me shkue ose në vend, ose ka me dalë jashtë. Ju lutem, mos ma testoni më këtë pjesë, se nuk bëj tolerime. Faleminderit shumë! Drejtoreshë, po ndërlihem edhe te fjala e z.Nexhat Selaj. Nuk mundemi me ndryshue diçka që na ka caktue ligji. Nëse jeni ju pro, me propozimin për ndryshim, atëherë e hedhim në votim. Është e kundërligjshme, propozimi për me ia hek kushtet ose kriteret qysh janë të përcaktume me ligj, është i jashtëligjshëm. Propozimi është i jashtëligjshëm. Mos e merr personale, edhe parëz të thashë, kurgjo personale s'kam, mirëpo është diçka e jashtëligjshme. Sidoqoftë, Kuvendi është këtu, e qesim në votim edhe s'prish punë. Por, prapë se prapë ka me na ardhë i jashtëligjshëm. A do me e marrë dikush fjalën, para se me e përmbyllë edhe me e qit në votim këtë çështje? Ka bo propozim edhe drejtoresha, edhe z.Munir Jonuzi. z.Munir Jonuzi ka thënë që te Neni 15 (Kolegjiumi Profesional të përbëhet nga pesë anëtarë) ka thënë që në mesin e tyre me pas edhe nga komunitetet, domethënë përbërja e tyre m'u konë edhe nga shqiptarë edhe nga pjesa e komuniteteve.

Munir Jonuzi: Në nenin 15 të shtoja këtu, duke respektuar diversiteti në strukturën e popullsisë. Prandaj, duhet të përfshihen edhe anëtarët nga komuniteti joshumicë.

Uran Halimi: Faleminderit! Propozimi i z.Jonuzi është që të Neni 15, te pika e parë, të respektohen edhe strukturat etnike, me u shtue kjo pjesa. Dikush tjetër a pat ndonjë propozim? Nedžmidini po e kërkon fjalën.

Nedžmidin Sejdar: Z. Kryesues, duke qenë se u sqaruar me drejtoreshen e kulturës për keqkuptimin dhe incidentin që keni pasur pak kohë më parë dhe keni kërkuar falje, do të ishte e drejtë që drejtoresha të dilte në foltore dhe t'u përgjigjej pyetjeve, mendoj se tani tensionet janë ulur dhe mund të vazhdojmë me punën normale.

Uran Halimi: Faleminderit! S'po ndihet fajtoresha për kurgjo. S'ka nevojë me dalë me kërkue falje, nëse s'e ndien ashtu veten. Drejtoresha përgjigjet s'deshti me m'i dhënë, se unë dy herë e pyeta, çka me bo qetash, me zor unë s'un e shti me m'u përgjigj, Nedžmidin. Nëse dësh me e marrë fjalën, del! Po shumë sinqerisht po të them, merre fjalën, përgjigju nëse ke me u përgjigj diçka. Po normal që unë kur të due. Kur ta kërkoni ju, una jua jap fjalën edhe e merrni fjalën. Atëherë po vazhdojmë me këtë pikën e rendit të ditës. E kemi propozimin e drejtoreshës, së pari. Kryetari po e kërkon fjalën.

Bexhet Xheladini: I nderuar kryesues, zv/kryesues, të nderuar delegatë, përfaqësues i OSBE-së, mjete të informimit, ju përshëndes të gjithëve! Ju falënderoj për prezencën tuaj këtu edhe debatin parlamentar që jeni duke e bërë. Unë do të kyçem menjëherë te Statuti i Muzeut. Është më mirë ta kesh një statut, sesa mos ta kesh fare. Edhe pse mund të ketë ndonjë gabim ky Statut, është shumë më i mirë sesa deri më tash që nuk e kemi pas, edhe e përgëzoj DKRS-në që e ka përgatit këtë Statut. Përgatitja e tij i ka përcjellë të gjitha procedurat ligjore, deri në Kuvend. Unë deshta ta falënderoj edhe kryesuesin, i cili kërkoi falje, sepse në aspektin kulturor nuk ishte një sjellje e mirë. I kërkoi falje drejtoreshës, është një gjest shumë i mirë. Ju i kërkuat asaj me i dhënë sqarime, ajo doli edhe nuk ia dhatë fjalën. Okej, në rregull, nuk është problem, nuk po e bëjmë tash problem këtë punë. Por, gjest i mirë ke që kërkove falje. Po drejtoreshën ti e thirre me dalë. Unë propozoj që ky Kuvend ta miratojë këtë Statut, i cili është përgatit nga DKRS-ja, me ndryshimet që i dha drejtoresha, edhe me plotësimet që i kërkoi zv/kryesuesi i Asamblesë. Unë po propozoj edhe diçka, që ky Statut të fillojë së implementuari në momentin kur të sigurohen mjetet financiare. Mjetet financiare ka mundësi që mund të sigurohen mas një viti e gjysmë, sepse tani mjete financiare nuk kemi mundësi, por do t'i fillojmë procedurat përmes KAB-it, të sigurojmë mjete financiare edhe për mirëmbajtjen e Muzeut, edhe për stafin. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Tash edhe një propozim na erdh, që të shtohet një Nen këtu në Statut, ku e saktëson kohën e saktë kur hyn në fuqi ky Statut. Jo siç shkruan në Nenin 28, që hyn në fuqi pas 15 ditëve, kryetari po thotë një vjet e gjys. Po ku e dimë na kur sigurohen ato? Duhet me e caktue një datë, o kryetar. Nexhat Selaj e kërkoi fjalën.

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe një herë! Kryesues – edhe për delegatë – përderisa Neni 13 është i tillë, është ligjor. Kryesues, ke durim të më përcjellësh. Po përderisa është me ndryshime, është joligjor. Si mund të futet në votim, kur nuk është ligjor?! Ne pak më parë e patëm një propozim të z.Ademi, ku thamë se është joligjor edhe nuk e qitëm në votim. Si mund të qitet tash në votim, kur është joligjor?! Po unë s'kam çka me të kuptue, ti tash vetë po merresh me urdhër, vetë po merresh me të premë. Parëz nuk e qite, tash po e qesim. Kur është joligjor, pse e qesim?

Uran Halimi: I nderum delegat, thashë që – s'e di a je konë këtu kur e kam thënë – thashë që, nuk e qitëm në votim një propozim joligjor të z.Driton Ademi, s'kemi qysh e qesim një propozim të drejtoreshës, kur është joligjor. A thashë qeshtu?

Nexhat Selaj: Pse po kërkojmë ne me qit me ndryshime? Po ti mundesh me thënë nuk është ligjor.

Uran Halimi: Atëherë, duhet me e hek propozimin e znj.Piraj, nëse e qesim në votim me ndryshime, ose përndryshe e lëmë. Po unë ta lexova ligjin, o i nderum delegat. S'ka lidhje a ka historian a s'ka historian, ligji i përcakton kriteret e konkursit, s'mundim na me i përcaktue kriteret e konkursit. Të nderum delegatë, është e jashtëligjshme, se kriteret e konkursit përcaktohen me ligj, është Ligji për

Zyrtarë Publikë. Na nuk mundim me i përcaktue kriteret e konkursit. Fjalën e ka kërkue Vetim Ramadani.

Vetim Ramadani: Faleminderit, kryesues! I nderum kryetar i Komunës, kryesues, zv/kryesues, anëtarë të Asamblesë Komunale, media! Realisht, nuk deshta shumë me u përfshi, po meqenëse kjo është një diçka që na përfaqëson të gjithëve. Ashtu siç u elaborua edhe më herët, ka fillue shumë herët iniciativa për themelimin e këtij Muzeu, përkatësisht ka stagnuar në një pikë, çështja e Statutit. Sa i përket Nenit 13, deshta ta jap një opinion timin, ndonëse nuk jam jurist i fushës, por besoj që si drejtor i Administratës kam njohuri sa i përket procedurave që zhvillohen, e sidomos procedurave të rekrutimit. Dua ta bëj një lidhshmëri me nenin të cilin nuk e kaloi në votim kryesuesi, sa i përket propozimit të z.Driton Ademi. Propozimi i z.Driton Ademi kishte të bënte me limitet e normativit të taksave. Nëse jam gabim në këtë pikë, më korrektoni. Ato limite përcaktohen përmes ligjit. Ndërsa, Neni 13 i Statutit të Muzeut nuk ka të bëjë me ligjin, pikërisht është ndesh me ligjin. Pse? Sepse ky është statut, nuk është konkurs. Në konkurs përcaktohen kriteret, a duhet të jetë tre vite përvojë pune, a duhet të ketë specializim në fushën e etnografisë, a duhet të ketë fakultet të historisë apo arkeologji, apo diçka të ngjashme. Unë mendoj që shumë më në rregull më ligjore do të ishte propozimi që neni i parë të jetë: "Menaxheri i Muzeut të zgjidhet personi i cili, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet të ketë edhe përgatitje superiore." Këto përgatitje superiore është çështje e konkursit. Kjo është ndesh edhe me Ligjin për Shërbyesit Publikë, sepse ato procedura i rregullon konkursi. Me këtë pjesën e dytë të paragrafit, ky më nuk ngjason si statut, por ngjason si konkurs. Për këtë arsye. Jo, nuk besoj që është personale, se megjithatë është institucioni i konkursit. Unë e pashë të arsyeshme vetëm të jap një mendim timin, prapë Asambleja e ka fjalën e vet. Faleminderit, kryesues!

Uran Halimi: Faleminderit shumë! E kemi zyrtarin ligjor, e kemi edhe ligjin, për atë unë po foli, jo veç për zyrtarin ligjor. Po sidoqoftë, na të jashtëligjshme vendime kemi marrë plot, po e marrim edhe këtë të jashtëligjshëm, mandej e kthejnë prapë. Po e qesim në votim.

Driton Ademi: Kryesues, e treta seancë je t'u dalë jashtë rendit të ditës. E treta seancë që je t'u dalë jashtë rendit të ditës. Domethënë, për çdo pikë është t'u të ikë rendi i ditës. Sot ke veprue kundërligjshëm. Ia ke marrë fjalën një deputetit, ia ke ndalue për propozim. Ti nuk je me na kallxue neve ligjin këtu. Kur ta propozoj unë, a e miraton Asambleja apo nuk e miraton, kjo nuk është çështje e jotja këtu, me na kallxue neve ligjin. E votojmë, e merr Ministria e Administratës, nëse e kemi gabim na kthen, e votojmë ndryshe. Edhe jam për me e votue ndryshe, nëse është gabim. Ama ti nuk je për me na dhënë as qet ligj, as ligjin për Muzeun, as kërkond. Unë s'e di pse po e marrish qaq personale, thuesh ti je zyrtar ligjor i MAPL-së. Po më vjen se je t'u e marrë rolin e MAPL-së këtu, e jo drejtimin e seancës. Plus e dyta, ti këtu je t'u ia u dhënë drejtorëve fjalën më shumë se që duhet. Unë nuk e di

qekjo Asamble Komunale, a është e drejtorëve komunalë, a është e Asamblesë. Drejtorëve u jepet fjala sa herë na ta kërkojmë fjalën. Mirë, veç deshta me të kallxue që ti, sot, nëse e qesish këtë në votim, me ndryshime, dije që e ke shkelë ligjin edhe për pikën e dytë. Veç këtë deshta me ta kallxue.

Uran Halimi: Falemnderit shumë, i nderum! Ju falënderoj shumë për këshillat që m'i jepni, më kallxoni edhe qysh e kam vendin, ku e kam vendin. S'keni nevojë me e bo këtë, se s'kam unë nevojë për këto këshillat e juaja, po sidoqoftë, ju po e bëni, atëherë po duhet me ju ngue. Sa i përket drejtorëve, drejtorët janë këshillëtarët e kryetarit. Kryetari ose del vetë folën, ose e autorizon një drejtor që na s'mundim me i thënë jo. Për qato na mbajmë seancë. Përndryshe, i qesim edhe kryetarin edhe drejtorët jashtë, edhe bëjmë çka dojmë na. Ajo është absurde. Është e panevojshme. Për atë është kryetari me këshillëtarët e vet. Kur ka diçka, del kryetari, kur s'do, e autorizon një këshillëtar të vetin. Okej, meqenëse është kaluar situata më shumë në personale sesa në procedurale, unë i kisha pranue me e qit në votim me ndryshime, me propozimet për ndryshime. E di që është e njëjta, po është personalizue situata edhe për me i ikë kësaj situatës që është bërë ma shumë personale se procedurale, atëherë... i kemi pesë minuta pauzë, ta hulumtojmë në detaje ligjin edhe po kthehemi në seancë.

Të nderum delegatë, ju lutem t'i zëni vendet e juaja, po vazhdojmë pikën e fundit të rendit të ditës. A do me e marrë dikush fjalën, para se ta hedhim në votim? Jetmir Ajdini e ka kërkuar fjalën.

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Në lidhje me Statutin e Muzeut të Komunës së Dragashit, është një statut që e keni prurë ju, qeverisja komunale, statut që e keni përgatit ju, nuk e di sa ju ka marrë kohë me e përgatit atë statut. Nuk ka nevojë me prurë ndryshime në seancë për diçka që e keni prurë me e votue. Për çfarë arsye nuk është përgatit mirë, me rregull, në kohë, me na ardhë vetëm për votim neve, si Statut i Muzeut. Nëse veç po kërkojmë ndryshime edhe janë jashtëligjore, për çka na me votue diçka jashtëligjore. Është krejt në rregull propozimi i Munirit, nëse duhet me u përfshi edhe minoritetet, që është gjithçka në rregull, ia votojmë qat propozim me ndryshim, nëse s'është cek në Statut. Por jo me shkue na me votue diçka jashtëligjore. Ju falemnderit! Edhe diçka: Nëse nuk tërhiqet ky propozim, unë do të jam kundër, nëse është jashtëligjore unë nuk do ta votoj. Ju falemnderit!

Uran Halimi: Të nderum delegatë, falemnderit shumë! Për shkak që menaxheri duhet të ketë diplomë, Nenin 1.2 e kemi këtu, të Muzeut të Kosovës, shkruan që menaxheri duhet të ketë diplomë universitare në njërin nga fushat si ajo e historisë, arkeologjisë, etnologjisë, muzeologjisë, politikave publike apo trashëgimisë kulturore, artit apo shkencave shoqërore. Për këtë arsye na propozimin e znj.Piraj duhet ta largojmë nga votimi edhe duhet ta qesim pikën e rendit të ditës me propozimet tjera, përveç kësaj që e ka bo znj.Liridona Piraj. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës, me propozimin e Munirit, që aty... me ndryshime, mirëpo propozimin e znj.Piraj nuk do ta përfshijmë. Kryetari po e kërkon fjalën.

Bexhet Xheladini: A është antiligjore a jo, atë e përcakton kur të na vjen vendimi i MAPL-së.

Sponsorues i këtij Statuti është Qeveria Komunale, gjegjësisht Drejtorati për Kulturë. Ti i qesish të dy propozimet, edhe propozimin e PDK-së, apo të Dritonit, edhe këto, cila të kalojë u krye. Nuk është antiligjore nëse shkruan bazuar në ligj, në Ligjin për Shërbyesit Publikë. Edhe Statuti i Muzeut të Kosovës i parasheh shumë kualifikime. Kështu që, i qesish dy propozimet edhe nuk është problem, për atë është Asambleja, me votue pro edhe kundër.

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe një herë! Po më duket se e zgjatëm shumë këtë propozim. Unë nuk po e di, kryetar, ku ishe pak më herët, kur ishte propozimi i z.Driton Ademi. Heshte, nuk reagoje fare. Tash s'po di, çka po ju dhëm tash? A mos është t'u u rujt ky vend i punës, ose nuk e keni njeriun e duhur, apo çka është në pyetje? Deri tash kemi diskutue 20 minuta për propozimin e Ademit, askush nga ju nuk mori fjalë. Tash, kur po vjen në pyetje me u hedhë me ndryshime propozimi i juaj, tash dalim ta qesim edhe të Dritonit. Nëse është ligjor, është edhe i Dritonit. Nëse nuk është, pse me i qit të dyjat. Shumë mirë po ceket. Edhe një diçka kisha me kërkue. Me sa po di, te ky Statut është hartuar nga Komisioni i Komunës, që kanë qenë pjesëmarrës pesë anëtarë ligjorë. Në mesin e këtyre anëtarëve, e kemi ne edhe kryesuesin, ose kryetarin e këtij Komisioni, z.Nexhat Tershnjaku. Unë kisha kërkue edhe nga Nexhat Tershnjaku, le të na japë pak një sqarim, të shohim ku janë bazue këta. Nuk është e hijshme të çojmë ne edhe të na kthejë. Ne jemi të gjithë të fushave këtu. Unë nuk po muj me e kuptue me e çue, me na kthye prapë, me ndryshime, pa ndryshime. Nëse është joligjore, është joligjore. Nëse është ligjore, është ligjore, e votojmë. Unë kisha kërkue, nëse më lejohet, që edhe Nexhat Tershnjaku, si kryetar i këtij Komisioni prej pesë anëtarëve, le të na japë një sqarim. Falemnderit!

Uran Halimi: Kryetari po e do fjalën.

Bexhet Xheladini: Nëse ju mendoni që është antiligjore, votoni kundër. Edhe e keni atë të drejtë, kërkush nuk jua mohon. Mos e përziej statutin me tarifate e tatimit në pronë! Drejtori shumë mirë tha, limiti i lejuar është 0.10%, nën të nuk bën. Nuk bën me shkue. Me pas thënë 0.13%, 0.15%, 0.17%, ke mund me bë zë. Mirëpo 0.10% është, nën të nuk e lejon ligji më. Edhe normal, ju keni mund, kryesuesi ka mund me e qit edhe propozimin e juaj në votim, edhe kalojke, na u kthejke prapë. Edhe të Statuti, nëse ju mendoni që është antiligjor, votoni kundër, e keni qat të drejtë edhe përfundon çështja e Statutit. Unë nuk anova, se për Ligjin për Tatimin në Pronë nuk dola me diskutue, por nëse mendoni që është bërë gabim, është dashtë me dalë me e dhënë propozimin, me votue për të dy variantet.

Uran Halimi: Nedžmidin Sejdilar e ka kërkue fjalën, pastaj z.Edin Kurt e ka fjalën.

Nedžmidin Sejdilar: Të nderuar të pranishëm, pak më parë kryetari i komunes përmendi limite në ligj. Zoti kryetar, limitet në ligj nuk janë vetëm limite në numër. Nëse një ligj thotë që nuk duhet të kalojmë 0.15%, ligji kufizon edhe disa gjëra me fjalë. Pse doni bindshëm të ndryshoni statutin e muzeut, që menaxheri të mos jetë ekspert. A do të jetë arkeolog, historian apo i ngjashëm. Pak më parë drejtori i

administratës tha se ky nuk është konkurs por Statut. atehere pse te mos vendosim gjithcka sipas ligjit bashke me Statutin dhe pastaj te shohim ne konkurs si do te qeverisim veten. Në konkurs, ne duhet të udhëhiqemi nga të njëjtat ligje. Për mua është e paqartë pse kemi standarde të dyfishta në këtë kuvend. Pak më parë nuk mundëm ta hidhnim në votim propozimin sepse ligji nuk e lejon, tani gjysmë ore më vonë kërkojmë të votojmë diçka që ligji nuk na lejon ta bëjmë sërish. Nëse pak më parë i kemi shkurtuar një kolegu një propozim që ishte kundër ligjit, atëherë nuk mund të bëjmë një propozim që nuk është në përputhje me ligjin edhe tani për këtë muze. Kjo është absolutisht e qartë. Ne krijojmë statutin, nuk shpallim konkurs. Pse Statuti të mos jetë i njëjtë me atë që parashikon ligji dhe kur të vijë konkursi do të drejtohem me ligje dhe udhëzime administrative.

Edin Kurt: Nuk arrita te kuptoj gjithcka, ndaj kam nje pyetje, meqenese kemi nje ligj qe lidhet me kete ceshtje, me intereson a shkruhet ne ligj qe nuk mund te kemi apo nje person me diplome universitare nuk mund të punësohet. Sepse vetëm në atë rast ky propozim i drejtoreshes nuk është i saktë. Nuk mendoj se duhet të shkruhet në ligj që një person që do të punësohet nuk ka nevojë të ketë diplomë universitare për t'u punësuar. Jam dakord me propozimin që ka bërë Munir Jonuzi për personat që do të jenë në komision, që të jenë edhe persona nga komuniteti jo shumicë.

Uran Halimi: Fjalën e ka z.Shpetim Hajredini.

Shpetim Hajredini: Faleminderit, i nderuar kryesues! Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Pothuajse në çdo seancë po vjen puna kur po kemi konflikte personale. Kjo po vjen, në bazë meje, si pasojë e papërgjegjësisë së ekzekutivit. E thashë këtë, pasi që pothuajse çdo vendim që në vije, na vije i pakompletuar. Edhe gjatë seancës vijmë ndryshime, dhe pastaj ne natyrisht, pozitë-opozitë, po kemi konflikt, diskutime të panevojshme. Unë nuk po di dhe nuk po muj t'i vë pikë pse ekzekutivi po na lejon që ne të diskutojmë dhe të na nxit të diskutojmë për gjëra të tepruara, të panevojshme. Gjithashtu, në këtë rast po na lejon edhe të kemi paragjykime se çka do të ndodhë në këtë konkurs. Kjo, realisht të ju them, për mu nuk është befasi, pasi që në çdo seancë është bërë traditë. Por, edhe një herë ju kisha propozue ekzekutivit që në seancat e ardhshme të kenë kujdes dhe vendimet, materialin në tërësi të seancave, të na bien të kompletuar, dhe mos ta në lejojnë që ne pastaj ta çojmë seancën huq, me diskutime të pabaza, me diskutime të cilat nuk kanë vlerë dhe nuk ndikojnë në të mirën e qytetarëve. Do të kthehem pak mbrapa, tek çështja e ligjit që u diskutua se ligji nuk është i njëjtë për normat tatimore dhe në këtë rast të diskutimit që po e bëjmë për menaxherin, apo Nenin 13, i cili specifikon kushtet apo kriteret e menaxherit të Muzeut. Absolutisht, unë jam i bindur që ligji është ligj, dhe ligji, si për normat tatimore, si në këtë rast për menaxherin e Muzeut, është i njëjtë. Kur shkilet ligji, shkilet, edhe duhet të kthehesh mbrapa, ose shkojsh atje përballësh me pasojat. Dhe nuk mund të themi që nuk është i njëjtë, si për atë, si për këtë tjetrin. Ligji është i njëjtë për të gjithë. Por, ne e marrim dhe e

shpjegojmë ashtu si po na konvenon neve. Në fillim, në diskutimin tim të parë, thashë se do ta kisha mbështetur pa hezitim, kështu si na ka ardhur. Por tani ne po e shohim, si opozitë, që pozita dëshiron që të na shtyjë me ndryshimin që është kërkuar nga ana e drejtoreshës. Unë personalisht, por jam i bindur që edhe kolegët e mi do të më mbështesin, që nëse propozimi i drejtoreshës hidhet në votim me ndryshime, ne nuk do ta mbështesim. Nëse hidhet në votim pa ndryshime, e ka mbështetjen tonë. Kjo për arsye se, ne diskutuam edhe më herët, propozimin e Driton Ademit nuk e hodhëm në votim pasi që ishte kundërligjshëm. Dhe tani, kur po e citojmë ligjin, që ndryshimi i cili po kërkohet nga ana e drejtoreshës është kundërligjshëm, ne prapë po dojmë ta hedhim në votim. Kjo për mu absolutisht është e padrejtë dhe nuk është në rregull, pasi që një propozim i një asambleisti nga opozita hidhet poshtë pse është kundërligjshëm, vjen propozimi nga pozita, edhe pse është kundërligjshëm duhet të hidhet në votim. Ju i keni votat, ndoshta edhe mund ta kaloni, por nëse është kundërligjshëm ka me na u kthye prapë. Po na jena mësue për atë, nuk është problem, çdo vendim na vjen i kundërligjshëm, edhe një herë e kthëjmë prapë, e votojmë, e përmirësojmë pak, e rregullojmë, por më besoni që nuk është në rregull, sepse, e kam thënë edhe në seancën e kaluar, po dalim si të paaftë. Ne jemi njerëz të cilët, si trevë njihemi që jemi të shkolluar në të gjitha profesionet, dhe jemi profesionalë. Prandaj, prapë vendos shumica, unë e thashë vetëm atë që e mendoj unë dhe një pjesë e opozitës. Nuk po diskutoj për kolegët e mi asambleistë. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Falemnderit! Kryetari e ka fjalën.

Bexhet Xheladini: Dallimet janë shumë të vogla mes pozitës dhe opozitës. Mund të merret edhe ligjor edhe antiligjor, kështu që të mos bëhemi shumë cikrrimëtarë, unë po e propozoj variantin përfundimtar të Nenit 13, nen i cili është edhe në Statutin e Muzeut Kombëtar të Kosovës. Andaj, unë propozoj që Neni 13 të jetë: ‘Drejtori duhet të ketë diplomë universitare në njërin nga fushat e historisë, arkeologjisë, etnologjisë, muzeologjisë, politikave publike, trashëgimisë kulturore, artit apo shkencave shoqërore.’ Kështu shkruan në Statut edhe le të jetë kështu, të votojmë unanimit. Dëgjo, edhe propozimi i drejtoreshës është i bazuar në ligj, në Ligjin për Shërbyesit Publikë. Kur thuhet i bazuar në ligj, do të thotë edhe ai nuk ka qenë kundërligjor, edhe propozimet e opozitës nuk kanë qenë kundërligjore, po i definojmë këto edhe u krye. Dëgjo, për diçka që s’është shumë me rëndësi, duhet të dalim unikë.

Uran Halimi: Faleminderit shumë, kryetar! Fjalën po e kërkon z.Samidin Xheladini.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm! Unë me të vërtetë s’deshta me dalë me folë. Së pari po e falënderoj drejtoreshën që e ka bërë një punë të madhe, në bashkëpunim me një organizatë suedeze. Punë shumë e mirë, por gjithmonë, sa herë ka pas propozime, për statut, ndonjë propozim konkret, edhe qeveritë e kalume unë i kam mbështet pa hezitim. Unë këtu pashë diçka që po fshihet, edhe po flitet për një afat kohor mas një vit e gjys. Domethënë, ju opozita po e legjitimoni, edhe ka një mandat po ia jepni

LDK-së. Se paska pretendime diçka. Atë ju e dini çka mendoni, se unë po të bëj be që nuk di kurgjo. Po masi e dëshmuat, se mas dy vite implementimi, domethënë edhe një mandat paskan këta prapë të njëjtit me konë në pushtet. Unë deshta me ju thënë që ju i paskit dorëzue armët. Faleminderit shumë!

Uran Halimi: Faleminderit shumë, z.Xheladini! Nëse merret vendimi që me u implementue mas një viti ose dy viteve, është vendim i kësaj qeverisjes. Kushdo qoftë në qeveri mas dy vjete, duhet me e implementue, pa marrë parasysh a është PDK, a është LDK ose kushdo qoftë tjetër. S'ka të bëjë këtu me implementimin edhe me qeverisjen. Po e qesim në votim me propozimin për ndryshim të kryetarit, plus propozimin që ai me i pas tre vjet përvojë pune është, e kemi propozimin e z.Munir Jonuzi që me u përfshi edhe komuniteti joshumicë, edhe e kemi propozimin e kryetarit që me hy në fuqi mas një viti e gjys. Pa qare një datë duhet me e dhënë. Jo, në vendim, kryetar, pa qare e kemi me e dhënë datën. S'mundim me e marrë një vendim pa datë. Thoni në janar, për shembull 2025, edhe është në rregull. Atëherë mas 15 ditëve hyn në fuqi, qysh u konë, se s'mundim vendim pa afat me marrë. Në aspektin ligjor, s'mundim me marrë vendim pa afat. I bjer që kohëzgjatja s'ka me u ndryshue, ka me hi në fuqi mas 15 ditëve, masi të miratohet. Kush është pro këtij propozimi, me ndryshimet që i keni kërkuar? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë i kemi 26 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim. Faleminderit shumë që keni marrë pjesë në këtë seancë, shihemi në seancat e radhës!

Kryesuesi i Kuvendit

Uran Halimi